

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM

Nr.486, datë 25.7.2007

PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË ANIJEVE, QË TRANSPORTOJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË TYRE, NË PORTET E DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërprerjen e veprimtarisë së përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në portet e Durrësit dhe të Shëngjinit, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Veprimtaria e përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, të vazhdojë të kryhet në portet e tjera, të miratuara për këtë qëllim.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Copyright 2016 - www.ligjet.org